



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 180 prot.

Elbasan, me 21.01.2021

VENDIM

Nr 5 datë 21.01.2021

Për

trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2020-2021

Në mbështetje të nenit 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", e ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," e ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit miratimit të kërkesave online për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2020-2021, VBA Nr. 48, datë 20.11.2020 "Për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2020-2021", Relacionit të Administratorit "Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2020-2021" për studentët e shkëlqyer dhe në nevojë, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Të përfitojnë bursë financiare 7 studentë me rezultate, që vazhdojnë studimet në Ciklin e parë të studimeve, me program të parë studimi, në vitin e dytë e të tretë, si edhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Të përfitojnë bursë financiare 992 studentë me kriteret e tjera, nga data e regjistrimit në fillim të vitit, mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1064 studentë me kriteret e tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI

